


INDIKATORI I DOBISË SË AUDITIMIT

Indikatori i dobisë së auditimit, si një nga treguesit më domethënës të performancës së Institucioneve Supreme, llogaritet si raporti i dëmeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së, për çdo vit buxhetor.




Shënim: Indikatori i dobisë së auditimit llogaritet vetëm mbi parregullsitë dhe shkeljet e disiplinës financiare me dëm ekonomik.

INDIKATORI I DOBISË SË AUDITIMIT

8 Vite (2012-2019) vs 10 Vite (2002-2011)

Për 8 vitet 2012-2019 rezulton se për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH-së është kërkuar për t'u zhdëmtuar 82,2 lekë, ose 4 herë më shumë, se sa është kërkuar në periudhën 10 vjeçare 2002-2011 (21.1 lekë).

Zbuluar për çdo lekë të shpenzuar



DËMI EKONOMIK I ZBULUAR DHE HUMBJET NË FINANCAT PUBLIKE NGA SHKELJET FINANCIARE PËR VITET 2012 - 2019


Nga auditimet e ushtruara përgjatë 8 viteve 2012 - 2019, KLSH ka konstatuar:

A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej **254 miliardë lekë** ose **2 miliardë euro**.

B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve, si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara, në shumën totale prej **521 miliardë lekë**, afërsisht **4.2 miliardë euro**.

Në total KLSH ka konstatuar shkelje në shumën **774 miliardë lekë** ose afërsisht **6,2 miliardë euro**.


Dëmi ekonomik 10 vite (2002-2011) vs 8 vite (2012-2019)
(në miliardë lekë)



Në 8 vitet (2012-2019) nga KLSH është zbuluar 254 miliardë lekë dëm ekonomik ose 5,4 herë më shumë se dëmi ekonomik i zbuluar në 10 vitet 2002-2011, i cili llogaritet 47.4 miliardë lekë.

DËMI EKONOMIK

Dëmi ekonomik në harkun kohor 2002-2019 (në miliardë lekë)




KALLËZIMET PENALE 2002-2019

Numri i kallëzimeve penale dhe persona të kallëzuar penalisht 2002-2019


Nga të dhënat e grafikut del qartë se numri i kallëzimeve penale në 8 vitet e fundit 2012-2019 (336) është 2 herë me shumë krahasuar me periudhën 10 vjeçare 2002 – 2011 (168), gjithashtu numri i personave të kallëzuar penalisht është 2 herë më i lartë.

Numri kallëzimeve penale dhe persona të kallëzuar penalisht për vitet 2002-2011 (10 vjet) VS 2012 – 2019 (8 vjet)




REKOMANDIMET

Rekomandimet sipas natyrës së tyre për vitet 2012-2019




Rekomandime për ndryshime apo Përmirësim të legjislacionit dhe zbatimi i tyre, për vitet 2002-2019




- Propozim për ndryshim apo përmirësim legjislacioni rekomanduar
- Propozim për ndryshim apo përmirësim legjislacioni zbatuar

Masa organizative të rekomanduara dhe zbatimi i tyre, për vitet 2002-2019



| | 2002-2011 (10 vite) | 2012-2019 (8 vite) |
|-------------------------------|---------------------|--------------------|
| Masa organizative rekomanduar | 6741 | 19733 |
| Masa organizative zbatuar | 4957 | 6273 |

Masa disiplinore e administrative të rekomanduara dhe zbatimi i tyre, për vitet 2002-2019




| | 2002-2011 (10 Vite) | 2012-2019 (8 Vite) |
|---|---------------------|--------------------|
| Masa disiplinore dhe administrative rekomanduar | 6741 | 10157 |
| Masa disiplinore dhe administrative zbatuar | 4957 | 5313 |

AUDITIME PERFORMANCE

Në tetor 2012 u krijua Departamenti i Auditimit të Performancës, i cili gjatë gjithë periudhës 8 vjeçare ka vijuar të jetë një nga shtyllat kryesore të zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së.


Për vitet 2012-2019, KLSH ka përfunduar dhe evaduar 92 Auditime Performance, duke ushtruar auditime në 360 institucione në nivel qendror dhe vendor.



AUDITIME TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Me objektiv zhvillimin e Auditimit TI, nëpërmjet të cilit KLSH-ja synonte të bënte ndryshime themelore në përdorimin e Teknologjisë së Informacionit në punën e saj audituese, në dhjetor të vitit 2014 u krijua Drejtoria e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Në përputhje me objektivat e zhvillimit të KLSH-së dhe duke parë tendencën e kohës në drejtim të rëndësisë së auditimeve IT dhe rritjes së numrit të auditimeve, në nëntor 2018, Drejtoria auditimit IT kalon në Departament të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Numri i auditimeve IT në vitet 2015-2019






BOTIME TË REALIZUARA NGA KLSH NË VITET 2012-2019

KLSH vjen në tetë vitet e fundit 2012-2019 me një kolanë botimesh prej 113 libra, nga 12 botime në 20 vitet (1991-2011).

Kolana e botimeve të KLSH-së ka arritur në 113 tituj, ndër të cilët:

- 23 numra të Revistës Shkencore “Auditimi Publik” në gjuhën shqipe dhe angleze;
- 7 analiza vjetore të punës së KLSH-së;
- 10 botime që i dedikohen Performances së institucionit në shqip dhe në anglisht;
- 12 volume të shkrimeve të përmbledhura të audituesve në shtypin e përditshëm;
- 7 volume që lidhen me Konferencat Shkencore vjetore të KLSH-së;
- 23 Botime që lidhen me standardet e Auditimit (ISSAI-t);
- 20 tituj te tjerë që pasqyrojnë auditimet e KLSH-së në vitet 2012-2015, strategjitë e KLSH-së, historikun e INTOSAI-t;
- 1 Botim kushtuar Historikut të NIK;
- 5 Botime të GAO-s.



12 Botime në 20 Vjet (1991-2011)

113 Botime në 8 Vjet (2012-2019)

KONFERENCAT SHKENCORE VJETORE 2012 - 2019

KLSH gjatë viteve 2012 - 2019 ka vijuar traditën e mirë të organizimit të Konferencave shkencore, e cila nisi si risi në vitin 2012.

Gjatë 8 viteve janë zhvilluar shtatë konferenca të tilla:

- Konferenca e I Shkencore e KLSH-së (Dhjetor 2012) me temë "87 vjet KLSH në 100 vjet shtet shqiptar";
- Konferenca e II-të Shkencore e KLSH-së (Dhjetor 2013) me temë "Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotem"
- Konferenca e III-të Shkencore e KLSH-së (Tetor 2014) me temë "Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare";
- Konferenca e IV-të Shkencore e KLSH-së (Qershor 2016) me temë "Analiza e Riskut";
- Konferenca e V-të Shkencore e KLSH-së (Tetor 2017) me temë "Të auditosh për qëndrueshmëri dhe zhvillim";
- Konferenca e VI-të Shkencore e KLSH-së (Prill 2018) në bashkëpunim me SAI-n e Kuvajtit me temë "Auditim me bazë risku".
- Konferenca e VII-të (Nëntor 2019) "Young ALSAI 2019".



STRATEGJITË E ZHVILLIMIT TË KLSH-së

- Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së, 2013-2017
- Strategjia e Menaxhimit të Riskut
- Strategjia e Komunikimit të KLSH-së, 2017-2019
- Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së, 2018-2022

MENAXHIMI INSTITUCIONAL

DINAMIKA E TRAJNIMEVE TE KLSH PËR PERIUDHEN 2009-2019

Treguesi kryesor i progresit reflektohet në rritjen e numrit të trajnimeve që çdo auditues ka kryer gjatë vitit, duke arritur një nivel të kënaqshëm prej **3611 dite njerëz trajnime, ose referuar 145 audituesve efektive vjetorë, rezultojnë 25 ditë trajnimi mesatare vjetore per auditues në vit, (kundrejt 2.1 të arritura në 2011 dhe 3.1 ditë trajnimi/person të kryer në vitin 2010).**

Dite trajnimi per person




Arritja e një numri mestar prej 25 ditë trajnimi, në vitet 2012-2019, për çdo auditues shënon një rritje me **12 herë** kundrejt vitit 2011, kur ky tregues ishte minimal.

ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE TË INSTITUCIONIT


Siç shikohet qartë edhe nga grafiku struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë në favor të stafit auditues.

Trupa audituese në vitet 2011 - 2019



Mosha mesatare në KLSH në vitet 2011-2019


Mosha mesatare në KLSH në fund të vitit 2019 është 42.5 vjeç, nga 50 vjeç në vitin 2011.



MENAXHIMI INSTITUCIONAL

Komunikimi me qytetarët në vitet 2002-2019

Gjatë vitit 2012-2019, KLSH ka trajtuar 3565 letra dhe ankesa nga të cilat 1508 kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit dhe 2507 në kompetencë të KLSH-së. Të gjitha këto kërkesa janë adresuar për kompetencë në institucionet përkatëse.



Marrëveshje bashkëpunimi në vite 8 vite (2012-2019) vs 10 vite (2002-2011)



Marrëveshjet e bashkëpunimit sipas partnerëve në vitet 2012-2019

